



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 404/3 prot.

Tiranë, më 21.02.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 404/1, DATË 10.02.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESËS NR. 987 PROT., DATË 17.02.2021 TË PARAQITUR NGA SHTETASJA ZNJ. ROVENA TARAJ"

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e znj. Rovena Taraj me nr. 987 prot., datë 17.02.2021 ndaj veprimtarisë së magjistratit z. A.K., gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe me vendimin nr. 404/1, datë 10.02.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës nr. 987 prot., datë 17.02.2021 të paraqitur nga shtetasja znj. Rovena Taraj", bazuar në nenet 120, pika 1, shkronja b), 121, pika 2, shkronja a) të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendim duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Vlorë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Lagjja: "Bashkimi", Rruga: "Osman Haxhiu", Pallati 1258;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

